



Pranuar / Dorezuar Prilapen/Prilapato Received/Delivered	13.09.2022	2 viti god year	
Organ / Shënia Organ / Jedimca Org / Unit	Nr Prot Bil Prot Prot No	Shtojca Protog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	5366/2022		115



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.694/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.694/2022 të datës 09.08.2022 të parashtruar nga ankuesja nga Prishtina, me adresë banimi

kundër Vendimit me numër protokollit 10-521/12 të datës 19.07.2022 të Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Drejtësisë, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 13.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. *Aprovohet si e bazuar* ankesa me numër A.nr.694/2022 e datës 09.08.2022 e parashtruar nga ankuesja
- II. *Shfuqizohet* Vendimi me numër protokollit 10-521/12 i datës 19.07.2022 dhe Vendimi me numër protokollit 10-521/7 i datës 04.07.2022 të Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Drejtësisë dhe *çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë.*
- III. *Obligohet* Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Drejtësisë që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të rishqyrtoj aplikacionin e ankueses të datës 22.06.2022, duke marrë përsysh të gjeturat sipas këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesja më datë 09.08.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4613/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 10-521/12 të datës 19.07.2022 të Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Drejtësisë, për shkak të shkeljeve të dispozitave ligjore, aplikim të gabuar të dispozitave ligjore lidhur me procedurën e lëvizjes brenda kategorisë, dhe shkeljeve të parimeve të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publike që lidhen me procedurën e pranimit për lëvizje brenda kategorisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 10.08.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Drejtësisë. Ndërsa, Këshilli më datë 19.08.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat ndërlidhur me çështjen ankimore.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses me numër protokolli 4613/2022 të datës 09.08.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokolli 10-521/12 të datës 19.07.2022 të Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Drejtësisë; Vendimin me numër protokolli 10-521/7 të datës 04.07.2022 të Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Drejtësisë; Ankesën e ankueses e datës 05.07.2022; Njoftimin për verifikim paraprak i datës 19.07.2022; Pasqyre me rastin e aplikimit; Konkursin me Nr. Reference RN0009103 i datës 06.06.2022 për lëvizje brenda kategorisë për Avokat Shtetëror; Aplikacioni i ankueses; Dëshmi nga SIMBNJ; Diplomën me Nr. 2562 e datës 10.10.2011 e ankueses; Certifikatën me Nr. 50/2012 e datës 06.07.2013; Certifikatën e datës 04.06.2018; Vërtetimin me numër protokolli 3261/2022 të datës 06.06.2022; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punës i datës 31.12.2020 dhe 13.12.2021; Kontratën e marrëdhënies së punës e datës 01.11.2008; Ndryshimin dhe Plotësimin e Aktit të Emërimit i datës 19.11.2014; Vendimin me numër protokolli 3203/2018 i datës 07.06.2018; Emailin e datës 05.07.2022 nga A.Nuredini për ankuesen; Emailin e datës 05.07.2022 nga ankuesja për Emailin e datës 04.07.2022 dhe 22.06.2022 nga SIMBNJ për ankuesen; Konkursin me Nr. Reference RN0009054 i datës 16.05.2022 për lëvizje brenda kategorisë për Zyrtar i Lartë për Inspektim; Aplikacioni i ankuese; Njoftimi i datës 10.06.2022; Plotësimin e ankesës nga ankuesja më datë 15.08.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 10.08.2022; Përgjigjen në ankesë e datë 19.08.2022; Lista e aplikantëve; Lista e aplikantëve të aprovuar dhe refuzuar; Emailin e datës 08.07.2022 nga ankuesja për Aplikacionin e ankueses; Kërkesën për Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë e datës 11.08.2022; Përgjigjen e datës 12.08.2022 nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë; Dëshmi nga aplikimi i ankueses; Kërkesën shtesë e datës 15.08.2022 për Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë; Përgjigjen e datës 18.08.2022 nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë.



Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se është e bazuar ankesa e ankueses, sepse:

Nga administrimi i provave materiale rezulton së Ministria e Drejtësisë më datë 06.06.2022 ka publikuar njoftimin për shpallje të Konkursit me numër reference RN00009103 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën "Avokat Shtetrorë"-5 pozita, e në të cilin konkurs ka aplikuar dhe ankuesja. Në fazën e verifikimit paraprak, Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Drejtësisë me Vendimin me numër protokoll 10-521/7 të datës 04.07.2022 ka refuzuar aplikacionin e ankueses me arsyetimin se e njëjta nuk i plotëson kushtet e konkursit respektivisht nuk ka dorëzuar formularët e vlerësimit të rezultateve në punë për dy vitet e fundit.

Ankuesja më datë 05.07.2022 ka parashtruar ankesë në Divizionin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Drejtësisë kundër Vendimit me numër protokoll 10-521/7 të datës 04.07.2022, ndërsa kjo e fundit me Vendimin me numër protokoll 10-521/12 të datës 19.07.2022 ka refuzuar ankesën e ankueses si të pa bazuar.

Brenda afatit ligjor ankuesja ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin se Njësia e Burimeve Njerëzore me rastin e refuzimit të aplikacionit nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike për faktin që nuk ka bërë verifikimin sipas detyrës zyrtare sepse në sistemin e SIMBNJ-së në dokumentacionin e aplikimit kanë qenë të bashkangjitura vlerësimet e punës për dy vitet e fundit, si dhe të gjitha dokumentet tjera të kërkuara sipas konkursit, mirëpo që vet sistemi ka pas ngecje në bartje të të dhënave nga dosja e ankueses. Me tej shton se Vendimi me numër protokoll 10-521/12 i datës 19.07.2022 i Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Drejtësisë është nxjerr jashtë afatit të përcaktuar me Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Lidhur me shqyrtimin e themelësisë së pretendimeve ankimore, Kolegji ka analizuar dispozitat ligjore lidhur me procedurën e lëvizjes brenda kategorisë, përkatësisht :
Ligjin Nr.06/l-114 për Zyrtarët Publikë, neni 38 me të cilin është përcaktuar se: "*Plotësimi i pozitave të lira në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë. 2. Nëpunësit civilë të së njëjtës kategori në kuadër të Shërbimit Civil, që i plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e posaçme për vendin e lirë, mund të aplikojnë për plotësimin e një vendi të lirë, nëpërmjet procedurës së lëvizjes, sipas paragrafit 1 të këtij neni. Në procedurën e lëvizjes brenda kategorisë për kategorinë profesionale mund të aplikojnë vetëm nëpunësit e kësaj kategorie, të konfirmuar sipas nënparagrafit 4.1 të nenit 37 të këtij ligji...."*

Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, respektivisht nenin 40 ku thuhet se: "*...2. Lëvizja brenda kategorisë është procedurë konkurruese. Konkurrimi organizohet për secilën pozitë të lirë. 3. Konkurrimi për lëvizjen brenda kategorisë është e mbyllur dhe në të kanë të drejtë të marrin pjesë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil..., nenin 41 ku parashihet se: 1. Për të aplikuar për lëvizjen brenda kategorisë, duhet të plotësohen së bashku, kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën zhvillohet procedura e konkurimit. 2.Kushtet*



që duhet ti plotësojë kandidati për procedurë të lëvizjes brenda kategorisë janë: 2.1. të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon; 2.2. të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale; 2.3. të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende; 2.4. të jetë vlerësuar të paktën "mirë" për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit. 2.5. Në rastin e konkurrimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit. 3. Kërkesat e veçanta për pozitën e lirë përcaktohen sipas përshkrimit të punës dhe bëhen pjesë e shpalljes për konkurrim për lëvizjen brenda kategorisë" dhe nenin 45 ku theksohet se" 1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën konkurrohet. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga NJBNJ.

Andaj, në kuptim të dispozitave ligjore si me lartë si dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji i Këshillit vlerëson se organi i punësimit gjegjësisht Njësia e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Drejtësisë me rastin e nxjerrjes së vendimit të kontestuar me ankesë nuk ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike dhe si rrjedhojë gabimisht ka zbatuar dispozitat materiale, sepse sipas vlerësimit të Kolegjit, Njësia e Burimeve Njerëzore nuk ka ndërmarr asnjë veprim në kuptim të konstatimit të pretendimit të ankueses lidhur me ngecjet teknike në bartje të të dhënave të aplikimit, edhe pse ankuesja kishte ofruar dëshmi se ditë me parë ka aplikuar në konkurset për lëvizje brenda kategorisë me numër reference RN00009051 dhe RN00009054 të shpallura nga Agjencia për Informim dhe Privatësia, dhe se e njëjta ishte përfshirë në listën e ngushtë pas verifikimit paraprak, pasi që kriteret e përgjithshme formale kanë qenë tërësisht të njëjta sikurse në Konkursin me numër referencë RN00009103 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën "Avokat Shtetëror".

Po ashtu nga vlerësimi i shkresave të lëndës, Kolegji ka gjetur se Njësia e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Drejtësisë nuk ka publikuar listën e shkurtër lidhur me kandidatet që kanë plotësuar kushtet e konkursit me numër referencë RN00009103 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën "Avokat Shtetëror", ashtu siç përcaktohet me nenin 45 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku parashihet se: *Kandidatët që plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lire renditen në një listë të shkurtër në rendin alfabetik. Lista e shkurtër shpallet në pajtim me nenin 9 të kësaj Rregulloreje, jo më vonë se shtatë (7) ditë kalendarike nga data e mbylljes së pranimit të aplikimeve", dhe se Vendimi me numër protokoll 10-521/7 i Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Drejtësisë është nxjerrë jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 45 paragrafi 6 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku është përcaktuar se: "Brenda shtatë (7) ditëve nga data e njoftimit individual, në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni, kandidatët e njoftuar që nuk plotësojnë kushtet e aplikimit, kanë të drejtë të paraqesin ankesë të brendshme. Ankesa parashtrrohet më shkrim pranë NJBNJ. Ankesa shqyrtohet nga NJBNJ dhe vendimi njoftohet brenda shtatë (7) ditëve nga paraqitja e saj", rrjedhimisht ankuesja ka parashtruar ankesë kundër vendimit për refuzimin e aplikacionit të ankueses më datë 05.07.2022, ndërsa Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve në Ministrinë e Drejtësisë më datë 19.07.2022 ka nxjerrë Vendim me numër protokoll 10-521/12 për refuzimin e ankesës së ankueses, pra dymbëdhjetë (12) ditë pas ditës së paraqitjes së ankesës, andaj, nisur nga ky konstatim rezulton se pretendimi i ankueses në këtë kuptim është i bazuar.*

Kolegji i Këshillit bazuar në të gjeturat dhe konstatimet si me lartë, konstaton së vendimi i kundërshtuar me ankesë është i përfshirë më të meta të atilla që pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së tij, kështu që Njësia e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Drejtësisë në ri procedurë duhet të rishqyrtoj aplikacionin e ankueses dhe të nxjerr vendim në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe në mbështetje të fakteve të vërtetuara në mënyrë të plotë dhe drejtë.

Siç u tha me sipër, Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.694/2022

Avdyl BEKTESHI

Bektashi
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Ardita Haxhnikaj
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë;
- Udhëheqësit të Njësies së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

